

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6793
E enjte, 29 dhjetor 2022
çmimi 0.40 €

Kuvendi Komunal i Skenderajt,
i Gjakovës, i Rahovecit dhe
i Vitisë e përkrahin simbolin
e lulëkuqes | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PËR SHKAK TË BARRIKADAVE, TRI PIKA KUFITARE QË E LIDHIN KOSOVËN ME SERBINË
AKTUALISHT JANË TË BLOKUARA | FAQE 4-5

SHBA-ja DHE BE-ja, TË SHQETËSUARA PËR TENSIONET E VAZHDUESHME NË VERI



Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian kanë bërë me dije se janë duke punuar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe me presidentin e Serbisë,

Aleksandër Vuçiq, për të gjetur një zgjidhje politike që të ulen tensionet në veri. Uashingtoni dhe Brukseli u bënë thirrje të gjithëve që të marrin veprime të menjëhershme për

shtensionimin e situatës në këtë pjesë. Misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR-i, ka theksuar se e mbështet dialogun ndërmjet të gjitha palëve për t'i zbutur tensionet në veri

AKTUALE



ABAZOVIQI NUK SHQETËSOHET PËR MESAZHET E PERËNDIMIT PËR NGRIRJEN E NEGOCIATAVE ME MALIN E ZI F. 2

KOSOVA DO TË STREHOJË PESË GAZETARË AFGANË F. 3

KURTI BASHKË ME VITINË PËRURONJË QENDRËN KOMBËTARE TË MJEKËSISË SPORTIVE F. 7

EKONOMI



XHUBLETA NË PULLA POSTARE TË KOSOVËS F. 8

SHTYHET EDHE PËR GJASHTË MUAJ AFATI PËR KTHIMIN E 10-PËRQINDËSHIT NGA TRUSTI F. 8


SPORT



TIFOZËT KUQEZI NË PRITJE TË TRAJNERIT TË RI, MUND TË JETË CAMBIASSO F. 12



KDI-ja: KUVENDI PËRMBUSHI 69 PËR QIND AGJENDËN LEGJISLATIVE GJATË KËTJË VITI
| FAQE 3



RIHAPET AEROPORTI "ADEM JASHARI" PAS KËRCËNIMIT TË RREMË ME BOMBË
| FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Abazoviqi nuk shqetësohet për mesazhet e Perëndimit për ngrirjen e negociatave me Malin e Zi

PODGORICË, 28 DHJETOR - Kryeministri me mandat teknik i Malit të Zi, Dritan Abazoviqi, deklaroi se nuk shqetësohet për mesazhet e partnerëve perëndimorë të cilët paralajmëruan mundësinë e ngrirjes së negociatave të Bashkimit Evropian me Malin e Zi nëse shumica parlamentare formon një qeveri të re në bazë të ndryshimeve kontestuese të Ligjit për Presidentin. “Për momentin unë nuk jam shumë i ngarkuar me këtë”, u tha Abazoviqi gazetarëve në Budva më 27 dhjetor.

Me iniciativën e Frontit Demokratik pro-Rus, më 12 dhjetor shumica parlamentare miratoi amendamentet në Ligjin për Presidentin.

Me miratimin e këtij ligji kjo shumicë do të marrë një pjesë të kompetencave të presidentit Milo Gjukanoviqi në zgjedhjen e qeverisë së re.

Më 26 dhjetor deputetët e lëvizjes URA të Abazoviqit, Fronti Demokratik pro-Rus dhe Demokratët, i dorëzuan Gjukanoviqit 41 nënshkrime në mbështetje të kandidatit të Miodrag Lekiqit për formimin e Qeverisë së Malit të Zi.

Ata i kërkojnë presidentit të mbajë konsultime me partitë dhe ta propozojë Lekiqin si kandidat. Nëse nuk e bën këtë, shumica parlamentare do ta propozojë pasardhësin. Këtë e mundëson Ligji i ndryshuar për Presidentin, i

cili ia merr autoritetin kushtetues Gjukanoviqit për të emëruar një përfaqësues, sepse në shtator, për arsye formale, ai refuzoi t’ia besonte Lekiqit mandatin për formimin e qeverisë.

BE-ja ka bërë me dije se negociatat me Malin e Zi mund të ngrihen nëse në bazë të këtij ligji formohet qeveria. Edhe ShBA-ja disa herë ka thënë se janë kundër hyrjes së Demokratikëve pro-Rus në qeveri.

Mirëpo Abazoviqi tha se nuk e rëndojnë mesazhet nga Perëndimi. Ai shtoi se “nuk është në interesin e askujt” që Mali i Zi të hyjë në “ndonjë keqkuptim ndërkombëtar”. “Nuk pres që të ketë ndonjë keqkuptim të madh në nivel ndërkombëtar dhe as nuk mendoj se subjekti që unë përfaqësoj, por më duket se as subjektet e tjera në asnjë mënyrë nuk do të bëjnë ndonjë veprim për ta prishur atë”, tha ai.

I pyetur se çfarë do të ndodhë nëse Gjukanoviqi nuk inicion konsultime të reja për mandatarin e qeverisë së re, Abazoviqi tha se kjo do të thotë se kundërshtohet vullneti i 41 deputetëve të cilët janë shumicë në Parlamentin malazez, i cili ka gjithsej 81 ulëse. “Nëse ai mendon se do t’i sjellë ndonjë përfitim politik, le të vazhdojë, as nuk do të zgjasë shumë, mandati i tij gjithsesi po përfundon dhe së shpejti do të kemi një president të ri”, tha ai.

Ai nuk tregoi se kur pritet formimi



i qeverisë së re dhe shtoi se “nuk ka ndonjë marrëveshje të veçantë” me Frontin Demokratik pro-Rus dhe se ende po diskutohet për përbërjen e kabinetit, qëllimet dhe parimet e qeverisë së re.

Gjukanoviqi ka nënshkruar dekretin me të cilin hyn në fuqi Ligji i kontestuar për Presidentin por, gjithashtu, ka thënë se nuk do të marrë pjesë në zbatimin e

tij, sepse e konsideron atë jokushtetues.

Mendim negativ për Ligjin ka dhënë edhe Komisioni i Venecias, organ këshillues i Këshillit të Evropës.

Gjykata Kushtetuese, e cila duhet të vendosë për kushtetutshmërinë e këtyre ndryshimeve, ka më shumë se tre muaj që nuk ka kuorum, sepse ka vetëm tre gjyqtarë nga gjithsej shtatë.

Që nga rënia e qeverisë, Abazoviqi është në mandat teknik që nga 20 gushti.

Kjo është qeveria e dytë që bie në Malin e Zi, që nga ndryshimi i ekzekutivit në gusht të vitit 2020, kur fitorja e Frontit Demokratik pro-Rus, Demokratëve dhe lëvizjes URA të Abazoviqit, i dha fund mbretërimit tridhjetëvjeçar të Gjukanoviqit.

Gjukanoviqit i skadon mandati presidencial në pranverë.

Yoon: Koreja e Jugut duhet t’i përgjigjet çdo provokimi të Koresë së Veriut

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Presidenti i Koresë së Jugut, Yoon Suk-yeol, tha se çdo provokim i Koresë së Veriut duhet të përballlet pa hezitim me hakmarrje pavarësisht prej armëve bërthamore që ka Phenjani. Këto komente të lëshuara nga zyra e presidentit jugkorean erdhën pasi dronët e Koresë së Veriut hyn në territorin e Jugut.

Pesë dronë të Koresë së Veriut kaluan në territorin e Koresë së Jugut të hënën, duke detyruar ushtrinë e Jugut t’i aktivizojë avionët dhe helikopterët luftarakë për t’i rrëzuar dronët.

Kjo ishte hera e parë që nga viti 2017 që Koreja e Veriut ka bërë një inkursion të tillë. “Ne duhet të ndëshkojmë e të hakmerremi ndaj çdo provokimi të Koresë së Veriut. Ky është mjeti më i fuqishëm për t’i zbrapsur provokimet”, tha Yoon gjatë një takimi me këshilltarët e tij. “Ne nuk duhet të kemi frikë apo të

hezitojmë vetëm pse Koreja e Veriut ka armë bërthamore”, shtoi ai.

Inkursionin e hënës nxiti kritika në Korenë e Jugut për aftësitë mbrojtëse të shtetit. Yoon kritikoi ushtrinë për dështimin që t’i rrëzojë dronët, të cilët fluturuan për orë të tëra mbi territorin e Koresë së Jugut. Ushtria e Koresë së Jugut kërkoi falje për mënyrën se si është përgjigjur pas futjes së dronëve të Koresë së Veriut, duke argumentuar se dronët ishin shumë të vegjël dhe ishte vështirë që të rrëzoheshin.

Koreja e Jugut më pas u kundërpërgjigj duke dërguar dronë mbi Korenë e Veriut, të cilët fluturuan për tri orë. Raportet midis Koresë së Veriut dhe Koresë së Jugut kanë qenë të tensionuara për dekada me radhë, por tensionet janë rritur qëkur qeveria e Yoonit mori mandatin në muajin maj dhe tregoi se ka një politikë më të ashpër me Veriun.



Botohet nga “Epoka e re” • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

KDI-ja: Kuvendi përmbushi 69 për qind agjendën legislative gjatë këtij viti

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të mërkurën një konferencë për medie, gjatë së cilës ka shpalosur vlerësimin mbi kualitetin e punës së Kuvendit të Kosovës përgjatë vitit 2022.

Në aspektin ligjvënës Kuvendi ka pasur një performancë mjaft pozitive.

Shikuar në numra, në mbi 100 seanca të mbajtura Kuvendi ka arritur të miratojë 111 projektligje, apo 69 për qind të projektligjeve të cilat i janë sjellë për shqyrtim, ndërsa 50 projektligje ende ndodhen në procedurë të shqyrtimit. Një ndër faktorët kryesor që ka ndikuar në këtë performancë është shumica e konsoliduar parlamentare, e cila ka mundësuar numrat për kalimin e projektligjeve. Në aspektin përmbajtësor pjesa më e madhe e projektligjeve të miratuara i përkasin sektorit të bujqësisë dhe atij drejtësisë.

2022-ta vlerësohet vit i kapitalizmit të iniciativave ligjore që ishin në pritje për t'u miratuar tash e shumë vite. Pas një dekade kjo legjislaturë përfundimisht miratoi Rregulloren

e re të Punës. Gjithsesi, efekti i saj nuk ishte i vërejtshëm në kuptim të planifikimit të punimeve të Kuvendit. Organizimi i punës së Kuvendit nuk u bë sipas një planifikimi të mirëfilltë e sistematik, gjë që rezultoi në stërngarkimin e seancave me numër të madh të projektligjeve, mospërfundimin e seancave dhe mbajtjen e disa seancave brenda një dite.

Po ashtu, këtë vit u miratua edhe Projektligji për Financimin e Subjekteve Politike, që ishte në pritje të miratimit që nga viti 2018, i cili avancoi transparencën dhe llogaridhënien financiare të subjekteve politike.

Në mungesë të vendosjes së sanksioneve për mospjesëmarrje të deputetëve në seanca apo në proces të votimit, situatat ku deputetët munguan në seanca dhe votim kanë qenë shumë të shpeshta. Gjatë këtij viti janë evidentuar mbi 1 700 mungesa të deputetëve vetëm në seancat plenare dhe kjo ka bërë që seancat në disa raste të dështojnë në mungesë të kuorumit. Numri i lartë i mungesave vjen edhe si rezultat i bojkotimit të punimeve të Kuvendit nga ana e deputetëve të Listës Serbe. Bojkotimi i punës së

Kuvendit nga komunitetet joshumicë, përveç mungesave si të tilla, ka rezultuar edhe me paralizim të disa iniciativave tejet të rëndësishme ligjore, për të cilat nevojiten votat e komuniteteve joshumicë. Në anën tjetër, përpos mungesave të deputetëve në seanca, në shumë raste aty munguan edhe anëtarët e kabinetit qeveritar.

Me një numër të madh të projektligjeve dhe temave të tjera në diskutim, debatet parlamentare nuk munguan, por që ato shpesh ishin jocilësore dhe jashtë temës. Në përgjithësi subjekti politik në pushtet nuk ishte shumë i hapur për t'i reflektuar propozimet dhe amendamentet e opozitës lidhur me përmbajtjen e projektligjeve. Kjo rezultoi në disa raste me polarizime politike dhe mospjesëmarrje të opozitës në shqyrtimin e iniciativave ligjore. Madje, për pasojë, disa nga projektligjet e miratuara u sfiduan dhe paralajmërohen të sfidohen në Gjykatën Kushtetuese.

Administrimi i seancave është parë si një element pozitiv.

Kryetari i Kuvendit ka luajtur një rol balancues në mes të kërkesave të opozitës dhe opozitës, duke amortizuar kështu përplasjet në

mes tyre. Përmirësime ka pasur edhe sa i përket gjuhës dhe sjelljeve parlamentare të deputetëve. Sidoqoftë, Kuvendi ka vijuar problemin e mostransparencës sa iu përket votimeve, meqë votimi ka vazhduar të bëhet me ngritje të dorës e jo përmes sistemit elektronik.

Në aspektin mbikëqyrës, Kuvendi vazhdon të ketë performancë të ulët. Në komisionet parlamentare vazhdon të ekzistojë një disproportion i theksuar ndërmjet punës në shqyrtimin e ligjeve dhe monitorimit të zbatimit të ligjeve, sidomos në aspekt të shqyrtimit të mirëfilltë të raporteve të performancës së agjencioneve të pavarura. Komisioni për Buxhet, Komisioni për Ekonomi dhe Komisioni për Legjislacion janë komisionet më të angazhuara përgjatë këtij viti, ndërsa përgjatë tërë vitit janë mbajtur 30 mbledhje të komisioneve.

Kuvendi gjatë këtij viti mori një rol të rëndësishëm në procesin e reformës në sektorin e drejtësisë, konkretisht në adresimin e procesit të vetingut në drejtësi dhe themelimit të Byrosë për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Për vetingun në fund të këtij viti u

formua një Komision Ad-Hoc parlamentar, i cili do t'i shqyrtojë amendamentet kushtetuese dhe Projektligjin për Vetingun. Këtu duhet vlerësuar pozitivisht vullneti politik i përbashkët në mes të pozitës dhe opozitës për të trajtuar këtë proces në mënyrë konsensuale. Ndërsa sa i përket Byrosë, me iniciativë të kryetarit të Kuvendit, projektligji është dërguar dy herë për opinion në Komisionin e Venecias. Fatkeqësisht, ky proces nuk është shoqëruar nga e njëjta frymë konsensuale sikur në rastin e vetingut.

Bazuar në vlerësimin e punës së Kuvendit për vitin 2022, KDI kërkon që sfidat që e përcollën këtë legjislaturë në këtë vit duhet të adresohen qysh në fillim të sesionit pranveror 2023. Zbatimi i Rregullores së re të Punës, që mundëson një planifikim më të mirë të punës e mbikëqyrje më të madhe të zbatimit të ligjeve, duhet të jetë prioritet. Po ashtu, KDI kërkon më shumë përgjegjësi nga deputetët për të marrë pjesë në seanca dhe për t'u përfshirë në debate të mirëfillta parlamentare që u shërbejnë ligjeve më të mira. Po ashtu, kërkohet funksionalizimi i votimit elektronik për ta rritur llogaridhënien parlamentare.



Kosova do t'i strehojë pesë gazetarë afganë

Prishtinë, 28 dhjetor - Kosova do të strehojë për dy vjet pesë gazetarë afganë të cilët po ikin nga persekutimi në shtetin e tyre. Atyre do t'u mundësohet ta vazhdojnë punën e tyre nga Kosova.

Qeveria e Kosovës më 28 dhjetor ka miratuar buxhetin

prej 30 mijë eurosh për strehimin e afganëve. "Kjo shumë mbulon shpenzimet për periudhën e mbetur të vitit 2022. Identifikimi dhe përzgjedhja e gazetarëve do të bëhet nga Federata Evropiane e Gazetarëve dhe Qendra Evropiane për Liri të Shtypit dhe

Medias në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës", tha zëvendësministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kreshnik Ahmeti.

Përveç buxhetit për strehimin e tyre, qeveria miratoi edhe kërkesën për mbrojtjen e përkohshme për gazetarët

afganë. Ky është projekti i dytë që Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës po realizon për gazetarët e huaj. Strehim dhe kushte të njëjta u është ofruar edhe gazetarëve nga Ukraina pas nisjes së pushtimit rus. Pasi në gusht të vitit të kaluar talebanët rimorën pushtetin,

Kosova pranoi kërkesën e Shteteve të Bashkuara për strehimin e refugjatëve afganë, që ishin të rrezikuar nga talebanët. Kosova ka strehuar përkohësisht 1 893 refugjatë afganë dhe më pas ata janë dërguar në ShBA dhe në shtete të tjera.



PËR SHKAK TË BARRIKADAVE, TRI PIKA KUFITARE QË E LIDHIN KOSOVËN ME SERBINË
AKTUALISHT JANË TË BLOKUARA

ShBA-ja dhe BE-ja, të shqetësuara për tensionet e vazhdueshme në veri

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian kanë bërë me dije se janë duke punuar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, për të gjetur një zgjidhje politike që të ulen tensionet në veri. Uashingtoni dhe Brukseli u bënë thirrje të gjithëve që të marrin veprime të menjëhershme për shtensionimin e situatës në këtë pjesë. Misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR-i, ka theksuar se e mbështet dialogun ndërmjet të gjitha palëve për t'i zbutur tensionet në veri

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian thanë se janë duke punuar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, për të gjetur një zgjidhje politike që të ulen tensionet në veri të Kosovës. Në një deklaratë të përbashkët, ShBA-ja dhe BE-ja mirëpritën garancitë e lidërshiptit të Kosovës që konfirmuan se nuk ka lista për arrestimin e qytetarëve serbë ose përndjekjen e atyre që protestojnë paqësisht apo për vendosjen e barrikadave. Uashingtoni dhe Brukseli u bënë thirrje të gjithëve që të marrin veprime të

menjëhershme për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës. “Në të njëjtën kohë, sundimi i ligjit duhet të respektohet dhe çdo formë e dhunës është e papranueshme dhe nuk do të tolerohet”, thuhet në reagim. ShBA-ja dhe BE-ja kanë kërkuar nga palët që t'i zbatojnë “pa vonesa të gjitha detyrimet e dialogut” për normalizimin e marrëdhënieve që ndërmjetësohet nga blloku evropian. Tensionet në veri janë ngritur që nga nëntori, kur serbët u larguan nga institucionet e Kosovës. Por, tensionet kulmuan me vendosjen e barrikadave më 10 dhjetor nga disa serbë lokalë në shenjë pakënaqësie për arrestimin e një ish-polici serb të Kosovës.

Dejan Pantiq dyshohet se ka organizuar sulmin e 6 dhjetorit ndaj zyrtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ai ishte duke u mbajtur në paraburgim në një stacion policor në Jarinjë, më 28 dhjetor, por gjykata i ndryshoi masën e paraburgimit

me arrest shtëpiak.

Për shkak të barrikadave, rrugët që çojnë drejt pikëkalimeve kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak, që lidhin Kosovën dhe Serbinë, janë bllokuar.

Këto dy pika kufitare që nga 10 dhjetori janë të mbyllura.

Autoritetet në Kosovë më 27 dhjetor mbyllën edhe pikën kufitare të Merdarit, pasi në anën serbe të kufirit u vendosën barrikada.

Për vendosjen e barrikadave Kosova fajëson “grupet kriminale” që mbështeten nga



Pantiqi dërgohet në arrest shtëpiak, reagon ministrja Haxhiu

Prokuroria Speciale e Kosovës ka konfirmuar se Dejan Pantiqit i është ndryshuar masa e sigurisë nga paraburgimi në arrest shtëpiak. Pantiqi u arrestua më 10 dhjetor në pikën kufitare të Jarinjës. Sipas autoriteteve të Kosovës, ai dyshohet për organizimin e "sulmit terrorist" të 6 dhjetorit ndaj zyrtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Prokuroria ka theksuar se ky ndryshim u bë për shkak të gjendjes shëndetësore të ish-policit serb Dejan Pantiq. "Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në aspektin shëndetësor dhe

njëkohësisht aspektin human, i ka propozuar Gjykatës Themelore në Prishtinë zëvendësimin e masës së paraburgimit për të pandehurin Pantiq, pasi që i njëjti ishte në pamundësi t'i gëzojë të drejtat që u takojnë të paraburgosurve në qendrat e paraburgimit", u tha në njoftim.

Prokuroria tha se pas vizitave të ekipeve mjekësore të misionit të EULEX-it është konstatuar se Pantiq nuk ishte në gjendje të mirë shëndetësore dhe është rekomanduar që ai të dërgohej në një qendër spitalore, "megjithatë as ky rekomandim nuk u realizua". Ndaj këtij vendimi ka reaguar ministrja e Drejtësisë, Albulena

Haxhiu. Ajo ka theksuar se kërkesa dhe vendimi për zëvendësimin e masës ndaj Dejan Pantiqit është akti më i rëndë që mund t'i bëhej vendit nga institucionet që do të duhej të ishin shembulli më i mirë i mbrojtjes së qytetarëve dhe rendit tonë kushtetues. "Nuk di si ta kuptoj dhe si është e mundshme që dikush që akuzohet për një vepër aq të rëndë që ka të bëjë me terrorizëm, të shkoj në arrest shtëpiak madje, sipas legjislacionit, për shkak të peshës së rëndë të veprës penale, nuk mund të shqiptohet një masë e butë sikur ajo e arrestit shtëpiak", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".

Ajo ka shtuar se: "Nuk është se kemi pasur ndonjë ëndërr që sistemi i drejtësisë do të çlirohet pa reformën në drejtësi, por ama të ndodhë kjo që ndodhi sot, është e papranueshme dhe diçka që do të ngelet në historinë moderne të Kosovës".

Haxhiu ka thënë se në vend se institucionet e drejtësisë ta mbronin rendin kushtetues e qytetarët, njësoj sikur po angazhohet policia edhe fizikisht në veriun e vendit tonë, këta prej zyrrave të tyre marrin vendime aq të dëmshme e të cilat, përveç të tjerash, janë inkurajim për bandat kriminale e terroriste në veriun e vendit tonë.

mobilizojë gjithë potencialin e vet politik, diplomatik, intelektual e të sigurisë në përballje me këtë rrezik të madh. "I bëj thirrje kryeministrit që të sillet në përputhje me situatën e krijuar. Serbia nuk zbrapset me retorika boshe luftënxitëse e as me 'trimat e rrjeteve sociale'. Gjendja është e rëndë dhe kërkon maturi e koordinim jo vetëm me faktorin e brendshëm, por edhe me partnerët ndërkombëtarë. Njëkohësisht, lus partnerët e sigurisë, posaçërisht Uashingtonin, që ta marrin nën kontroll situatën në veri dhe ta ndalin përshkallëzimin e mëtejshëm, i cili paraqet rrezik edhe për paqen në rajon", ka deklaruar lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj.

Hoti propozon veprimet që nxjerrin Kosovën nga kurthi i Serbisë

Edhe ish-kryeministri Avdullah Hoti ka reaguar për situatën në veri. Ai ka paraqitur veprimet që nxjerrin Kosovën nga kjo kurth e Serbisë. "1. Hiqni barrikatad në veri në bashkëpunim me KFOR-in. I keni lënë të zënë vend tepër gjatë. 2. Kërkoni me ngulm nga BE-ja dhe ShBA-ja të bëjnë presion te Serbia të mos pengohen dhe të mos rrezikohen qytetarët tanë që kalojnë nëpër Serbi. 3. Ruajeni paqen fuqishëm. Tregoni gatishmëri për dialog dhe zgjidhje paqësore. Dëgjoni këshillat e miqve për veprimet që duhen ndërmarrë në kuadër të dialogut. 4. Mos përmendni luftë e konflikte. Luftën e kemi paguar shtrenjtë, por e kemi fituar me ndihmën e miqve. Rreziku është të humbim në paqe për shkak të humbjes së mbështetjes nga miqtë tanë", ka shkruar Hoti në "Facebook".

Serbia. Beogradi, ndërkaq, ka shprehur përkrahjen për barrikatad dhe ka thënë se ato nuk do të hiqen deri kur Prishtina ta formojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe.

Së fundi në veri janë regjistruar një sërë incidentesh me armë zjarri, granata dore dhe shok-bomba. Çak i sulmeve kanë qenë pjesëtarët e Policisë së Kosovës, të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR-i, ata të misionit të BE-së për sundim të ligjit, EULEX-i dhe gazetarët.

Misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, ka theksuar të mërkurën se mbështet dialogun ndërmjet të gjitha palëve për t'i zbutur tensionet në veri të vendit. "Është e rëndësishme që të gjitha palët e përfshira të shmangin çdo retorikë apo veprim që mund të shkaktojë tensione dhe ta përshkallëzojë

situatën", ka deklaruar komandanti i forcave paqeruajtëse të NATO-s në Kosovë (KFOR), Angelo Michele Ristuccia. "Zgjidhjet duhet të kërkohen përmes dialogut", shtoi ai.

Kurti: Po kalon me shpejtësi afati i KFOR-it për largimin e barrikadave

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se autoritetet "nuk do të bisedojnë dhe bashkëpunojnë me kriminelët" në veri, por do t'i "arrestojnë ata". Gjatë mbledhjes së Qeverisë së Kosovës të mbajtur më 28 dhjetor, Kurti foli për barrikatad e ngritura në veriun e banuar me shumicë serbe, duke argumentuar se ato po cenojnë integritetin territorial të Kosovës. "Patkeqësisht, këta kriminelë, të sanksionuar edhe nga ShBA-ja

dhe Britania e Madhe, po mbështeten nga presidenti dhe Qeveria e Serbisë me qëllim destabilizimin e rajonit, përveç cenimit të integritetit territorial të republikës sonë", tha Kurti.

Kosova i ka dhënë kohë misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, që të veprojë të heqë barrikatad. Por, autoritetet kanë paralajmëruar se nëse KFOR-i nuk vepron, Policia e Kosovës ka kapacitete për të bërë diçka të tillë. "Vendosja e barrikadave në rrugë është veprim i paligjshëm, i papranueshëm dhe nuk do të tolerohet. Në përputhje me vlerësimet e sigurisë, ne kemi dhënë kohën dhe hapësirën e nevojshme KFOR-it për të vepruar, por sigurisht që kjo kohë po shteron me shpejtësi", ka theksuar Kurti. Ai shtoi se parimi i lëvizjes së lirë dhe barrikatad në rrugë "nuk mund të qëndrojnë" së bashku.

Haradinaj: Gjendja mund të përshkallëzohet dhe të dalë krejtësisht jashtë kontrollit

Ish-kryeministri Ramush Haradinaj, duke komentuar situatën në veri, ka theksuar se skenari i regjimit pro-rus të Serbisë për destabilizimin e Kosovës po hyn në një fazë kritike. "Mbyllja e pikave kufitare njëra pas tjetrës, sulmet e grupeve kriminale të sponzorizuara nga Serbia ndaj qytetarëve, gazetarëve, policisë, EULEX-it e pjesëtarëve të KFOR-it dhe kujtdo tjetër që e kundërshton këtë skenar ogurzi, kanë marrë përmasa shqetësuese. Gjendja mund të përshkallëzojë dhe të dalë krejtësisht jashtë kontrollit", ka thënë Haradinaj.

Ai ka theksuar se në një situatë të tillë është urgjente që Kosova të



Fluks automjesh te Dheu i Bardhë

Gati tri javë pasi grupe serbësh nisën bllokimin e rrugëve që çojnë drejt vendkalimeve kufitare

me Serbinë në veri të Kosovës, barrikada u ngritën edhe në anën serbe të kufirit në Merdar - pjesa

verilindore e Kosovës. Ky vendkalim kufitar përdoret në masë të madhe nga diaspora e

Kosovës. Fluks automjesh janë parë të mërkurën në pikën kufitare Dheu i Bardhë pas

mbylljes së tri pikave të tjera kufitare me Serbinë - Jarinjë, Bërnjak dhe Merdar.

Kuvendi Komunal i Skenderajt, Gjakovës, Rahovecit dhe Vitisë përkrahin simbolin e lulëkuqes

SKENDERAJ, 28 DHJETOR - Kuvendi Komunal i Skenderajt, Gjakovës, Rahovecit, dhe Vitisë, kanë përkrahur kërkesën që lulëkuqja me katër petale të jetë simbol i përkujtimit të gjenocidit në Kosovë. Në

seancën e këtyre kuvendeve komunale të gjithë asamblistët votuan unanimisht deklaratën mbështetëse për kërkesën e Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur", që lulëkuqja me katër të jetë simboli unik i përkujtimit të viktimave të

gjenocidit në Kosovë. Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur" ka falënderuar të gjithë asamblistët që përkrahën kërkesën që lulëkuqja me katër petale të jetë simbol i përkujtimit të gjenocidit në Kosovë.



Jepen çmimet e manifestimit "Kadri Kadriu"



PODUJEVË, 28 DHJETOR - Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Kulturë në Podujevë ka organizuar manifestimin tradicional takimet e kulturës "Kadri Kadriu". Në orët letrare të manifestimit që u mbajtën në Teatrin e Qytetit "Avdush Hasani" mori pjesë kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Pajtim Balaj, artistë e artdashës llapjanë.

Kryetari Bulliqi u shpreh i lumtur që po vazhdohet tradita e shënimit të takimeve "Kadri Kadriu", që nga viti 1983, në kujtim të pedagogut dhe poetit Kadri Kadriu dhe në dhënien e mundësisë së krijuesve të rinj letrarë. "Në skenën kulturore të takimeve 'Kadri Kadriu' në Podujevë, përgjatë viteve kanë kaluar letrarë, piktorë, krijues të

rinj, jo vetëm të Llapit, por edhe të qyteteve të tjera të Kosovës dhe nga të gjitha trojet shqiptare", ka thënë Bulliqi.

Në manifestimin "Kadri Kadriu" u dhanë çmimet për esenë, poezinë dhe tregimin e shkurtër më të mirë, gjithashtu u dha edhe çmimi "Afrim Maliqi" në nderim të veprimtarit, poetit dhe gazetarit i cili u vra më 2 dhjetor 1998.

Vendi i parë u nda për esenë "Pavarësia mes dashurisë e luftës", e autorit Ilaz Hajra, vendi i dytë për poezinë "Podujevës", e autores Valëza Fusha, vendi i tretë "Hajni i Perdeve", e autorit Ramë Oraca, ndërsa pesë çmimet inkurajuese i fituan Gëzime Qerimi, Esma Islami, Arbona Llumnica, Majlinda Deda dhe Albiona Januzi, ndërsa u zgjodhën edhe lexuesit e dalluar të bibliotekës së qytetit.

Me rritjen e buxhetit mbi 100 për qind, bujqësia në Gjilan do të jetë një ndër sektorët më të zhvilluar

GJILAN, 28 DHJETOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka thënë se me rritjen e buxhetit për bujqësinë mbi 100 për qind, bujqësia do të jetë një ndër sektorët më të zhvilluar në Gjilan. Këtë deklaratë kreu i Gjilanit e ka bërë gjatë një punëtorie të organizuar për fermerët me temën "Planifikimi

dhe reformat në bujqësi", në të cilën kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës, përfaqësues të TIKA-s turke dhe organizatave të tjera relevante. "Para tyre shpalosëm disa nga projektet e planifikuara për vitin e ardhshëm, nga rritja e sipërfaqeve

me misër me qëllim të futjes së silazhimit si kulturë për përgatitje të ushqimit për kafshë; deri te sistemi i ujitjes, trajnimet e vizitat studimore për fermerë, subvencionimi i ruajtjes së pemëve, subvencionimi i qumështit e inseminimi artificial i kafshëve", është shprehur kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni.



Elvira Bajraktari, sportistja e vitit 2022 në Skenderaj

SKENDERAJ, 28 DHJETOR - Drejtorja për Kulturë, Rini e Sport e komunës së Skenderajt ka shpallur sportistët më të mirë për vitin 2022, me një ceremoni të organizuar, ku ishin të ftuar dhe të pranishëm sportistë, udhëheqës klubesh, veteranë të sportit dhe mysafirë të tjerë.

Në fjalën e tij para të pranishmëve, kryetari i komunës, Fadil Nura, tha

se ambasadorët më të mirë të shtetit tonë janë sportistët, ndaj të cilëve, siç vazhdoi kreu i Skenderajt, komuna do të jetë gjithmonë përkrah tyre duke i mbështetur në garat që ata marrin pjesë.

Sipas komisionit për zgjedhjen e sportistit të vitit në komunën e Skenderajt, epiteti i më të mirit për vitin 2022 i takoi voleybollistes

Elvira Bajraktari nga Klubi i Volejbollit "Skenderaj", skuadër kjo që arriti t'i sjellë qytetit tonë Kupën e Federatës së Volejbollit. Çmimin e vendit të parë e ndau kryetari i komunës, Fadil Nura. Klubi më i mirë u shpall KV "Skenderaj", kurse trajneri më i mirë u shpall Ylli Kadriu, kryetrajner i KV "Skenderaj", kurse çmimet i ndau nënkryetari Sami Lushtaku.

Largohet edhe një deponi mbeturinash nga kryeqyteti

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se po largohet edhe një deponi

mbeturinash nga kryeqyteti. "Kemi mbyllur këtë zonë plotësisht të lënë pas dore deri më tash për të mos lejuar

hedhjen e mbeturinave më tutje", ka shkruar Rama në "Facebook". Ai ka theksuar se, po ashtu, janë duke shqyrtuar

mundësinë për hapjen e një korsie të re që lidhet me magjistralen Prishtinë - Fushë-Kosovë.



Rihapet aeroporti "Adem Jashari" pas kërcënimit të rremë me bombë

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Policia e Kosovës tha se kërcënimi me mjete shpërthyes në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" ka rezultuar të jetë i rremë. Ky aeroport u mbyll për kohësisht më herët gjatë

28 dhjetorit, por policia tha se pas kontrolleve të kryera nuk ka gjetur asnjë mjet shpërthyes. "Pas përfundimit të kontrollit dhe punëve nga institucionet relevante, funksionimi dhe qarkullimi në aeroport i është kthyer

normalitetit", njoftoi policia. Zyrtarët e Aeroportit njoftuan më herët gjatë së mërkurës, se pas pranimit të kërcënimeve me bombë, ishin evakuuar të gjithë udhëtarët dhe personeli i aeroportit.



Kurti bashkë me Vitinë përurorjnë Qendrën Kombëtare të Mjekësisë Sportive

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Kryeministri Albin Kurti, së bashku me ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitia, morën pjesë në ceremoninë e përvitit të Qendrës Kombëtare të Mjekësisë Sportive dhe atë të Klinikës së Mjekësisë Fizikale me Rehabilitim në komunën e Prishtinës.

Në fjalën e tij kryeministri tha se është nder i veçantë pjesëmarrja e tij në këtë përvit të këtyre dy

objekteve ku tani sportistët tanë do të kenë më në fund një qendër që ofron shërbime mjekësore të asaj cilësie të lartë të cilën ata e meritojnë. "Tash e sa vjet jemi dëshmitarë se sportistët dhe sportistët tanë po arrijnë standardet më të larta të mundshme nëpër gara të ndryshme ndërkombëtare. Brenda një kohe të shkurtër ata e kanë vendosur Republikën e Kosovës në hartën botërore të sportit, duke i shërbyer kështu jo vetëm avancimit të karrierave të tyre individuale, por edhe forcimit

të shtetit të Kosovës dhe të imazhit të vendit tonë në arenën ndërkombëtare", është shprehur kryeministri.

Hapja e Qendrës Kombëtare të Mjekësisë Sportive, sipas kryeministrit Kurti, do të mundësojë, tani më shumë se kurrë, parandalimin e sëmundjeve dhe, njëherësh, diagnostifikimin e sëmundjeve të sportistëve, përmes kontrolleve sistematike shëndetësore. "Në këtë mënyrë sportistëve të Kosovës do t'u jepet mundësia të shkëlqojnë edhe më shumë gjatë

viteve të ardhshme edhe në Kosovë dhe në botë", veçoi ai.

Po aq e rëndësishme është edhe hapja e objektit të ri e Klinikës së Mjekësisë Fizikale dhe Rehabilitimit. Kjo klinikë, shtoi më tej kryeministri, është struktura e vetme e kujdesit terciar shëndetësor në Kosovë, e cila ofron shërbime të diagnostifikimit si dhe të trajtimit të veçantë të patologjive të ndryshme përmes terapisë fizikale dhe të rehabilitimit. Paralelisht me përmirësimin e infrastrukturës fizike, Qeveria e

Republikës së Kosovës po punon intensivisht edhe për përditësimin e infrastrukturës ligjore në fushat e mjekësisë sportive dhe mjekësisë fizikale dhe rehabilituese.

Këto përditësime, tha më tej ai, po synohen të bëhen përmes një ligji të ri për shëndetësi nga njëra anë dhe përmes procesit të planifikimit strategjik në fushën e sportit në anën tjetër. "Hapja e këtyre dy objekteve të reja sot është vetëm fillimi, kursesi përfundimi i bashkëpunimit tonë", ka thënë kryeministri Kurti.



MKRS-ja, marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Prishtinës

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) ka njoftuar se gjatë vitit të kaluar ka filluar shënimin e ditëve të rëndësishme kulturore përmes Kalendarit Kulturor. Për zhvillimin dhe zbatimin e këtyre aktiviteteve tash është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina",

Fakultetin e Arteve.

Kjo marrëveshje parasheh thellimin e bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Kulturës dhe UP-së në ideimin, konceptimin, realizimin, promovimin dhe zhvillimin e Kalendarit Kulturor të Ministrisë së Kulturës me të gjitha datat përkatëse në bazë vjetore. Marrëveshja u

nënshkrua nga ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, rektori i UP-së, Qerim Qerimi dhe dekani i Fakultetit të Arteve, Hazir Haziri. "Kjo do të jetë një mundësi e mirë edhe për studentët që të angazhohen në organizimin e ngjarjeve kulturore dhe, po ashtu, të marrin pjesë në to", ka njoftuar MKRS-ja.



Kushtetuesja konstaton se Inspektorati i Punës nuk ka kompetencë për kthimin e punëtorëve në vendin e punës



PRISHTINË, 28 DHJETOR - Shoqëria e Avokatëve "Vokshi & Lata" ka shpjeguar se si Inspektorati i Punës nuk ka kompetencë për kthim e punëtorëve në vendin e punës. Sipas tyre, ligjshmëria e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është kompetencë e Gjykatës Kushtetuese dhe se ky inspektorat nuk mund ta bëjë një vlerësim të tillë. "Gjykata Kushtetuese e Kosovës përmes Aktgjykimit K027/21 konstaton se Inspektorati i Punës nuk është 'gjykatë' apo 'tribunal i pavarur' pasi që është pjesë e ekzekutivit dhe se mbikëqyrjen e Ligjit të Punës

dhe Ligjit për Mbrojtje dhe Siguri në punë mund ta bëjë vetëm përmes shqiptimit të gjobave", thuhet në njoftimin e kësaj shoqërie. "Shqyrtimi i ligjshmërisë së vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është kompetencë ekskluzive e Gjykatës dhe Inspektorati i Punës nuk mund të bëjë një vlerësim të tillë. Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese vjen pas shumë vitesh të tejkallimit të kompetencave ligjore nga Inspektorati i Punës ku në shumë raste Inspektorati i Punës ka marrë vendim për kthim në punë të punësuarve", thekson njoftimi. Po ashtu, theksohet se

Kushtetuesja ka konstatuar se Ligji i Punës është zbatuar gabimisht nga Inspektorati i Punës dhe gjykatat. "Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se neni 94 i Ligjit të Punës 03/L-212 është në përputhshmëri me Kushtetutën, por që është zbatuar gabimisht nga Inspektorati dhe në disa raste edhe nga gjykatat. Roli i Inspektoratit të Punës është tejet i rëndësishëm, por ky rol duhet zbatuar në përputhje me kufizimet e përcaktuara nga ligji dhe pa interferuar në çështjet që janë kompetencë e gjykatës", thuhet në njoftimin e Shoqërisë së Avokatëve "Vokshi & Lata".



Xhubleta në pulla postare të Kosovës

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Filatelia e Postës së Kosovës ka lëshuar në qarkullim postar emisionin e jashtëzakonshëm të pullave postare të titulluar "Nga trashëgimia - xhubleta", e cila u përfshi në Listën e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale në nevojë për mbrojtje urgjente nga UNESCO në vitin 2022. Xhubleta, veshja tradicionale me origjinë të lashtë, tipike për gratë e Shqipërisë së Veriut, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi, është një fund popullor i valëzuar, në formë zileje që përbëhet nga një numër i madh copash e rripash të ngushtë shajaku, të vënë horizontalisht dhe të ndërthurur me breza gajtanësh. Ajo mbahet e varur në supe me dy rripa të gjerë. Në shekullin XVIII xhubleta bëhej me shumë ngjyra, por ngjyrat që kanë arritur në ditët e sotme janë: e zeza për gratë dhe bardhë e zi për vajzat.

Pjesë të tjera të kostumit me xhubletë janë krahoninët, xhoka, kërdhokulla, paraniku, kallmat e shputat etj. Xhubleta është një fund në trajtë kambane, që vjen e valëzuar përfundi, sidomos në pjesën e prapme. Xhubleta e Malësisë së Madhe është trashëgimi e qartë e kulturës sonë Iliriane nëpërmjet së cilës ne paraqesim historinë e humbur të kombit tonë që malësorët tanë e përcollën deri në vitet 1950 -1960, pra është e vetmja që jep identitetin e kombit shqiptar nëpërmjet motiveve, ku emblema më e dukshme për të gjitha është shqiponja. Filatelia e Postës së Kosovës, kësaj radhe nga thesari i etnologjisë, na sjell imazhin e bukur të Xhubletës në pulla postare, përmes të cilave do të promovojë kudo nëpër botë vlerat e trashëgimisë kulturore dhe materiale të pafundme që ka atdheu ynë.

Shtyhet edhe për gjashtë muaj afati për kthimin e 10-përqindëshit nga Trusti

PRISHTINË, 28 DHJETOR - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që ta shtyjë edhe për gjashtë muaj afatin për fillimin e rimbursimit të 10-përqindëshit, pra të mjeteve të tërhequra nga Fondi i Kursimeve Pensionale (Trusti) rreth dy vjet më parë. Sipas ministrit të Financave, Hekuran Murati, shtyrja e këtij afati do të jetë deri në

fund të muajit qershor 2023. "Në vendimin bazë ka qenë e paraparë që deri në fund të këtij viti të bëhej një formë aplikimi për personat që do të duhej të rimburosoheshin, sipas ligjit që parashihet. Megjithatë, meqë na duhet afat shtesë për këtë gjë, kemi kërkuar që të ndryshohet ky vendim dhe afati deri në fund të qershorit të vitit të

ardhshëm, pra gjashtë muaj shtesë", ka thënë Murati në arsyetimin e vendimit. Me anë të këtij vendimi rimbursimi i mjeteve të Trustit do të realizohet nga Ministria e Financave në bashkëpunim me Fondet Pensionale. Aplikimi për kthimin e mjeteve do të hynte në fuqi më 31 dhjetor 2022.



Tregjet e rrjetit të errët gjenerojnë miliona të ardhura nga shitja e të dhënave personale që janë vjedhur



Nga Christian Jordan
HOWELL & David MAIMON

Sot është e zakonshme të dëgjosh lajme mbi shkelje të mëdha të të dhënave. Por çfarë ndodh kur vidhen të dhënat e tua personale? Studimi ynë tregon se si ashtu me shumicën e mallrave legale, produktet e të dhënave të vjedhura rrjedhin përmes një zinxhiri furnizimi të përbërë nga prodhues, shitës me shumicë dhe konsumatorë.

Por ky zinxhir furnizimi, përfshin ndërlikohen e organizatave të shumta kriminale, të cilat veprojnë në tregje të paligjshme. Ai fillon me prodhuesit – hakerët që shfrytëzojnë sistemet e cenueshme dhe që vjedhin informacione të ndjeshme si numrat e kartave të kreditit, kodet e llogarisë bankare dhe numrat e sigurimeve shoqërore.

Më pas, të dhënat e vjedhura reklamohen nga tregtarët e shumicës dhe shpërndarësit që i shesin të dhënat. Dhe në fund, të dhënat blihen nga konsumatorët që i përdorin për të kryer forma të ndryshme mashtrimi, përfshirë transaksione mashtruese me kartën e kreditit, vjedhje të identitetit dhe sulme kibernetike “phishing”

(peshkimit, pra hakerimit të telefonit të dikujt përmes dërgimit të një linku).

Ky trafik i të dhënave të vjedhura midis prodhuesve, shitësve me shumicë dhe konsumatorëve mundësohet nga tregjet e errëta (darket), të cilat janë faqe interneti që i ngjajnë faqeve të zakonshme të tregtisë elektronike (online), por që janë të aksesueshme vetëm duke përdorur shfletues të veçantë ose kode të veçanta të autorizimit.

Gjatë kërkimit tonë, ne zbuluan mijëra shitës që shisnin dhjetëra mijëra produkte të dhënash të vjedhura në 30 tregje të errëta. Këta shitës kishin më shumë se 140 milionë dollarë të ardhura gjatë një periudhe 8-mujore. Ashtu si faqet tradicionale të tregtisë elektronike, edhe tregjet e rrjetit të errët ofrojnë një platformë për shitësit, që i lidh shitësit me blerësit e mundshëm për të lehtësuar transaksionet.

Por këto tregje janë të njohura për shitjen e produkteve të paligjshme. Një tjetër dallim thelbësor, është se qasja në tregjet e rrjetit të errët kërkon përdorimin e softuerit të veçantë si Onion Router, ose TOR, i cili ofron siguri dhe anonimitet. Silk Road, që u shfaq për herë të parë në vitin 2011, kombinoi TOR dhe Bitcoin për t'u bërë tregu i parë i njohur si darknet.

Ky treg u zbulua në vitin 2013 dhe themeluesi i tij, Ros Ulbriht, u dënua me 2 burgime të përjetshme plus 40 vjet, pa mundësinë e lirimit me kusht. Dënimi i rëndë i Ulbriht nuk dukej se pati efektin e synuar parandalues. Sepse tregje të shumta të ngjashme u shfaqën për të mbushur boshllëkun, dhe në këtë mënyrë krijuan një ekosistem të lulëzuar që përfitonte nga të dhënat personale të vjedhura.

Duke njohur rolin e tregjeve të rrjetit të errët në trafikimin e të dhënave të vjedhura, ne kryem ekzaminimin më të madh sistematik të tregjeve të të dhënave të vjedhura, për të cilat jemi në dijeni, për të kuptuar më mirë madhësinë dhe shtrirjen e këtij ekosistemi të paligjshëm në internet.

Për këtë, ne identifikuan fillimisht 30 tregje të rrjetit të errët që reklamoinin shitjen e të dhënave të vjedhura. Më pas, mblodhëm informacione mbi produktet e të dhënave të vjedhura nga tregjet çdo javë për 8 muaj me radhë, nga 1 shtatori 2020 deri më 30 prill 2021. Më pas e përdorëm këtë informacion për të përcaktuar numrin e shitësve që shesin të dhënat e vjedhura, numrin e produkteve të reklamuar, numrin e produkteve të shitura si dhe shumën e të ardhurave të krijuara.

Në total, kishte 2.158 shitës që reklamuan të paktën një nga 96.672 listimet e produkteve në 30 tregje të errëta. Shitësit dhe listat e produkteve, nuk u shpërndanë në mënyrë të barabartë nëpër tregje. Mesatarisht, tregjet kishin 109 pseudonime unike të shitësve dhe 3.222 listime produktesh në lidhje me produktet e të dhënave të vjedhura.

Kështu Marketplaces regjistroi 632.207 shitje në këto tregje, të cilat gjeneruan 140.337.999 dollarë të ardhura. Gjithsesi në këtë treg ka një variacion të lartë. Mesatarisht, tregjet kishin 26.342 shitje dhe gjeneruan 5.847.417 dollarë të ardhura. Pas vlerësimit të tipareve të ekosistemit, ne analizuar individualisht secilin prej tregjeve. Në këtë mënyrë zbuluam se një pjesë e vogël e tregjeve të errëta, ishin përgjegjëse për trafikimin e shumicës së produkteve të të dhënave të vjedhura. Tre tregjet më të mëdha, Apollon, WhiteHouse dhe Agatha, përmbanin 58 për qind të të gjithë shitësve. Numri i listimeve varioje nga 38 në 16.296, ndërsa numri i përgjithshëm i shitjeve varioje nga 0 në 237.512. Edhe të ardhurat totale të këtyre tregjeve ndryshonin ndjeshëm gjatë periudhës 35-javore: ato variojnë nga 0 dollarë në 91.582.216 dollarë

për tregun më të suksesshëm, Agatha. Sa për krahasim, shumica e kompanive të mesme që operojnë në SHBA, fitojnë nga 10 milion deri në 1 miliard dollarë në vit.

Si Agatha ashtu edhe Cartel fituan të ardhura të mjaftueshme brenda periudhës 35-javore që ne i gjurmuam ato, respektivisht 91.6 milion dollarë dhe 32.3 milion dollarë. Tregje të tjera si Aurora, DeepMart dhe WhiteHouse ishin gjithashtu në rrugën e duhur për të arritur të ardhurat e një kompanie të mesme nëse kishin në dispozicion një vit kohë.

Këto tregje të rrjetit të errët janë të vështira për t'u shkatërruar drejtpërdrejt. Por përpjekjet për të penguar përdorimin nga zotëruesit e të dhënave të vjedhura, ofron njëfarë shprese. Ne besojmë se përparimet në Inteligjencën Artificiale, mund t'u ofrojnë agjencive të zbatimit të ligjit, institucioneve financiare dhe të tjerëve informacionin e nevojshëm për të parandaluar përdorimin e të dhënave të vjedhura për të kryer mashtrime. Kjo mund të ndalë rrjedhën e të dhënave të vjedhura përmes zinxhirit të furnizimit, dhe të sabotojë ekonominë informale që përfiton nga vjedhja dhe shitja e të dhënave tuaja personale. / “The Conversation” – Bota.al

La Rinconada, të vërtetat e errëta mbi qytetin që ndodhet në ‘çatinë’ e botës



I fshehur brenda maleve mistike të Andeve në Peru, dhe saktësisht rrëzë majës më të lartë të malit Ananea dhe nën akullnajën La Bella Durmient (Bukuroshja e Fjetur), ndodhet qyteti La Rinconada. “Rinconada” do të thotë në spanjisht “qoshe” ose “cep”. Dhe në fakt ky është një nga qoshet më të vështira në botë për të jetuar.

Qyteti ndodhet në lartësinë 5.100 metra mbi nivelin e detit. Efektet e kësaj lartësie të madhe – së bashku me temperaturat e acarta – mbi trupin e njeriut janë shumë të forta. E megjithatë, 50.000–70.000 njerëz kanë zgjedhur të jetojnë këtu.

La Rinconada-s i mungon pjesa më e madhe e infrastrukturës, sistemeve jetike dhe institucionet e sigurisë publike, që ka zakonisht një qyteti funksional. Këtu nuk ka ujë të rrjedhshëm apo hidraulike të brendshme, vend-depozitime të mbeturinave apo ujërave të zeza, energji elektrike, shkolla, spitale apo sisteme ngrohjeje.

Shpeshherë banorët e këtij qytetit

refuzojnë përfshirjen ose ndikimin e qeverisë peruane, ndërsa kushtet e jetesës janë shumë më të ulëta sesa standardet mesatare në këtë vend. Për këtë arsye zona nuk është një destinacion turistik i preferuar, dhe për më tepër nuk është as elehtë për t’u aksesuar nga vizitorët.

Prandaj nuk është e habitshme që këtu nuk ka hotele. Banorët argëtohen duke frekuentuar disa kafene, bare, dhe një ekip futbollit që e kanë krijuar disa vite më parë. Mungesa e funksioneve të nevojshme të një qyteti, shkakton pasoja shëndetësore serioze, duke përfshirë uljen e cilësisë së jetës dhe jetëgjatësisë.

Për çdo njeri të zakonshëm, jetesa në një lartësi prej mbi 5100 metra mbi nivelin e detit do të ishte shumë e vështirë. Gjithsesi në përgjithësi komuniteti që jeton në La Rinconada i është përshtatur kushteve ekstrem. Por ajo me të cilën nuk janë përshtatur dot banorët, është ndotja e madhe dhe helmimi nga mercuri.

I gjithë uji i tyre i pijshëm vjen nga një liqen aty pranë, i cili është shumë i ndotur me merkur, ujëra të zeza dhe rrjedhje kimikatesh nga mbeturinat. Duke pasur parasysh që njerëzit i djegin plehrat e tyre për t’i asgjësuar ato, edhe ajri është i ndotur me helme si mercuri dhe cianidi. Zonat përreth, si liqeni Titikaka – liqeni më i madh në Amerikën e Jugut, që është një burim kryesor i ujit të pijshëm – ndoten nga veprimtaria e banorëve në La Rinconada. Për shkak të gjithë këtyre faktorëve, banorët jetojnë shpeshherë vetëm rreth 30–35 vjeç, dhe vdesin nga sëmundjet dhe problemet me mushkëritë, si dhe dëmtimi i sistemit nervor, që mund të shkaktojë humbje të përhershme të kujtesës, paralizë, deformime, njolla në lëkurë dhe madje edhe vdekje.

La Rinconada u themelua fillimisht si një qytezë minatorësh, sepse mali Ananea është i pasur me ar. Ky metal i çmuar është nxjerrë në Andet për qindra vjet. Gërmimet

këtu datojnë qënga koha e qytetërimeve Inkase. Sot Peruja zë vendin e tetë të botës për eksportin e arit.

Dhe pavarësisht temperaturave shumë të ulëta dhe kushteve të tmerrshme të jetesës, është pikërisht ari, ai që sjell banorë të rinj në këtë qytet. Popullsia është rritur me mbi 230 për qind gjatë 10 viteve të fundit. Por shumë nga aventurierët që vijnë këtu vetëm me ëndrën e lavdisë, nuk e kanë të garantuar se do të kenë pasurohen. Kur u ngritën minierat, ato menaxhoheshin fillimisht nga një kompani minerare private, e cila ndërtoi qytetin dhe punësoi banorët për të nxjerrë ar. Tani, ajo që njihet si “Parajsa e Djallit” drejtohet nga bandat, si dhe organizatat lokale që nuk janë aspak dashamirëse ndaj kompanive minerare private apo ndaj qeverisë peruane.


Ata kanë zhvilluar një sistem pagese të quajtur “cachorro”, ku minatorët punojnë falas për 30 ditë rresht dhe

në ditën e 31-të mund të mbushin xhepat e tyre me aq ar sa mund të mbajnë me vete. Përveç asaj që në thelb është një punë skllëvërisht, minatorët vdesin në masënë galeritë e minierave, ndërsa gratë trafikohen për prostitucion. Sipas banorëve, me rënien e pranisë së arit në mal po shtohet edhe dhuna dhe konsumi i alkoolit.

Gratë nuk lejohen të punojnë në miniera, sepse banorët besojnë se kjo do të shqetësojë ‘shpirtin femëror’ të zonës. Ndaj ato merren me ndarjen e mineralit, duke e ndarë arin

nga mercuri. Nëse dikush do të dëshironte të shkonte në La Rinconada për 1–2 gramë ar qëpunëtorët thonë se mund të çojnë në shtëpi në një javë, ata do të duhej të ndërmermin një udhëtim shumëditor në një rrugë të rrezikshme. Por jeta që do të gjejnë atje, është akoma më e rrezikshme.

Marrë me shkurtime nga grunge.com – bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Kukësi në bisedime edhe me Lushtakun

KUKËS, 28 DHJETOR - Skuadra shqiptare, Kukësi, është në kërkim të një trajneri të ri dhe duket se vëmendja e drejtuesve të klubit për ta gjetur njeriun e duhur është nga Kosova.

"Panorama" kishte raportuar dje se Bylbyl Sokoli mund të jetë një prej trajnerëve që mund të drejtojë Kukësin, por më afër se Sokoli del të jetë Tahir Lushtaku. Ish-trajneri i Drenicës është në

komunikim me presidentin e Kukësit dhe palët duket se janë pajtuar për shumë pika. Ende nuk dihet nëse Lushtaku do të drejtojë Kukësin por, sidoqoftë, në rast se ai merr drejtimin e

skuadrës shqiptare, nuk do ta ketë shumë të lehtë punën. Kukësi ndodhet në vendin e parafundit në tabelë me vetëm 15 pikë, 14 pikë më pak se Partizani në vendin e parë.



Tifozët kuqezi në pritje të trajnerit të ri, mund të jetë Cambiasso

TIRANË, 28 DHJETOR - Janë ditët e fundit të vitit dhe shumë tifozë të ekipit kombëtar të Shqipërisë presin në njëfarë mënyre në formë dhurate edhe zyrtarizimin e trajnerit të ri që do t'i udhëheqë kuqezinjtë në kualifikueset e radhës, të cilat do të nisnin në muajin mars. Në prononcimet e fundit, kreu i FShF-së, Armand Duka, është shprehur se janari do ta gjejë Shqipërinë me një trajner të ri, çka pritet të shihet. Kandidati potencial për të ardhur në krye është Esteban Cambiasso, çka ka vizituar dhe darkuar në Tiranë pak kohë më parë.

Argjentinasi pritet t'i plotësohen kushtet dhe ta fillojë punën në Shqipëri. Ish-lojtari i Interit dhe Real Madridit nuk ka një përvojë të madhe në drejtim, teksa vetëm për një periudhë tremujore ka qenë ndihmëstrajner i Pekermanit te kombëtarja e Kolumbisë, vetëm për Botërorin e vitit 2018 në Rusi. Kështu, një zyrtarizim i tillë do të quhej edhe një eksperiment me ekipin kombëtar, që në fund të kompeticioneve do të shihet si ka rezultuar, mirë apo keq. Por në ditët e fundit në skenë ka dalë edhe kolumbiani Reinaldo Rueda.



Fitojnë lakersat, Bostoni dhe Denveri



ORLANDO, 28 DHJETOR - Ekipi i lakersave rikthehet te fitorja në NBA pas fitores me rezultat 129-110 arritur në fushën e Orlandos. LeBron Jamesi me 28 pikë ishte lider për kalifornianët, ndërkohë që 49 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit. Denveri vijon ta komandojë renditjen në Perëndim, duke mposhtur me rezultat 113-106 Sacramento. Porter me 30 pikë e Murray me 25 pikë bën dallimin në fushë për Denverin. Fitojnë edhe clippersat, që falë 4 lojtarëve që realizuan mbi 20

pikë, mposhtën Toronton me rezultat 124-113. Në Lindje vijon të komandojë skuadra e Bostonit, që mundi 126-102 Houstonin, ndeshje ku dallimin në parket e bën Browni me 39 pikë e Tatum me 38 pikë. Skuadra e Phoenixit, falë 26 pikëve të Washingtonit (e nisi ndeshjen nga stoli), mundi me rezultat 125-108 Memphis. Fitore të rëndësishme për "play-off"-in korri Dallasi, që mundi me shifrat 126-121 New York. Luka Donçiqi, i papërmbajtshëm, duke vendosur rekordin sezonal, me 60 pikë, 21 rebounde e 10 asistime. Fitojnë edhe kampionët e Golden States, që mundën me rezultat 110-105 Charlotte (Klay Thompson 29 pikë).

REZULTATET	
Orlando - Lakers	110-129
Washington - Philadelphia	116-110
Boston - Houston	126-102
Indiana - Atlanta	129-114
Toronto - Clippers	113-124
Memphis - Phoenix	108-125
Oklahoma - San Antonio	130-114
Dallas - New York	126-121
Golden State - Charlotte	110-105
Sacramento - Denver	106-113

Ten Hag për Ronaldon: I përket së kaluarës

MANCHESTER, 28 DHJETOR - Manchester Unitedi shkëlqen pa Cristiano Ronaldon, "djajtë e kuq" e rinisin me një fitore të bukur 3-0 përballë Nottingham Forestit. Në "Old Trafford", ofensiva e Ten Hagut

ishte e kolauduar në perfeksion, ku dyshja Rashford - Martial gjetën dy herë rrugën e rrjetës brenda 22 minutave. Rashford finalizoi me shumë klasë brenda në zonë një skemë të

përkryer nga goditja e këndit, ndërsa pak minuta më pas dhuroi një asistim për Martial. Në fundin e ndeshjes, në minutën e 87, ishte Fred që sigloi shifrat përfundimtare në 3-0. Ten Hag u ngacmua

sërish në lidhje me Ronaldon: "Unë shoh një skuadër shumë të uritur, nuk shoh pas, por vetëm të ardhmen. Ronaldo zgjodhi të na përshëndeste, tani ai nuk është më pjesë e grupit".





Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020 si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 307/2022 të datës 15 Shkurt 2022, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

VAZHDIM I KONKURIT

I. Zyrtar për Buxhet dhe Financa

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, një (1) pozitë

Referenca:	KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ - 028
Emri pozitës:	Zyrtar për Buxhet dhe Financa
Pozita:	Pozitë e karrierës
Niveli:	Profesional
Raporton tek:	Udhëheqësi i Divizionit
Numri i pozitave:	Një (1) pozitë
Koeficienti:	Shtatë (7)
Akti i emërimit:	Pa afat
Puna Provuere:	Dymbëdhjetë (12) muaj
Vendi:	Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Ofron shërbime të buxhetit dhe financave me qëllim të mbështetjes në realizimin e aktiviteteve të Sekretariatit të KPK-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Përgatit dhe plotëson dokumentacionin e nevojshëm për certifikim dhe shpenzim të lëndëve; Në bashkëpunim me zyrtar tjerë ndihmon në planifikim të buxhetit dhe në përgatitje të KASH-it, Cash flow, Pasqyrave Vjetore Financiare dhe dokumenteve tjera të buxhetit; Regjistron të dhënat buxhetore dhe financiare në sistemet aktuale të buxhetit dhe financave; Siguron që të gjitha sistemet e kontrollit të brendshëm në lidhje me shpenzimet janë zbatuar dhe vendosur në rregullat dhe rregulloret organizative dhe financiare si dhe përcjell mbarëvajtjen e ndryshimeve financiare nga MF;

Ruan dhe i arkivon kopjet origjinale të të gjitha pagesave të proceduara për gjithë sistemin prokurorial;

Evidenton dhe raporton mbi gjendjen e zbatimit të buxhetit dhe për çdo ndryshim eventual të bërë në SIMFK;

Është përgjegjës për të gjitha avancet e udhëtimeve zyrtare sipas kërkesave;

Kryen detyra tjera të parashtruara nga mbikëqyrësi.

Njohuritë, shkathësitë aftësitë për vendin e punës:

Trajnim nga fusha e financave Njohja dhe aplikimi i programeve të Microsoft Office, si dhe softuerëve dhe web aplikacioneve financiare ;

Aftësitë e koordinimit, bashkëpunimit dhe komunikimit me zyrtaret dhe palët ;

Shkathësi të shkëlqyera organizative dhe ekipore si dhe për të punuar me udhëheqje minimale mbikëqyrëse ;

Të ketë aftësi për të punuar nën presion dhe në limite kohore ;

Fleksibiliteti dhe aftësia që të punoj me vëllim pune ;

Aftësi për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare- Fakulteti Ekonomik.

Përvoja e Punës:

Dy (2) vit përvojë pune profesionale.

- Konkursi është i hapur 7 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data 29.12.2022 deri me datë 04.01.2023 si datë e mbylljes së konkursit.
- Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati VII, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë.
- Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.
- Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.
- Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.
- Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:
- Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.
- Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
- "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuara të dokumentacionit të kërkuar:
- Dëshminë e kualifikimit shkollor;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Dëshmi e trajnimeve;
- Dy rekomandime (nëse keni);
- Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
- Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;
- Certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.
- Në lidhje me datën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, kandidatët do të njoftohen bazuar në legjislacionin në fuqi.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Na osnovu člana 31 Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu Zakona br.03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosova i Pravilnika br. 02/2010 o Postupku Zapošljavanja u Civilnoj Službi Kosova, u skladu sa Presudom br. Ref AGJ.1583/20 od 09. jula 2020. godine kao i Odluke Tužilačkog Saveta Kosova KPK/br. 307/2022 od 15 februar 2022. godine, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova ponovno objavljuje:

PRODUŽENJE KONKURSA

I. Službenik za Budžet i Finansije

Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, jedna (1) pozicija

Referenca:	KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/ POZ -028
Naziv pozicije:	Službenik za Budžet i Finansije
Pozicija:	Pozicija karijere
Funkcionalna kategorija:	Profesionalna
Raportira kod:	Rukovodioca Divizije
Broj pozicija:	Jedna (1) pozicija
Koeficient:	Sedam (7)
Akt imenovanja:	Na neodređeno
Probni rad:	Dvanaest (12) meseci
Mesto:	Priština

Cilj radnog mesta:

Pružna usluge budžeta i finansija sa ciljem podrške u realizaciji aktisnosti Sekretarijata TSK-a.

Glavne dužnosti i odgovornosti:

Priprema i popunjavanje potrebnu dokumentaciju za sertifikaciju i troškove predmeta;

U saradnji sa ostalim službenicima pomaže u planiranju budžeta i pripremu KAŠ – Cash flow, Godišnjih finansijskih pregleda i ostala dokumenta budžeta.

Upisuje budžetske i finansijske podatke u aktualnim sistemima budžeta i finansija.

Obezbeđuje da svi sistemi unutrašnje kontrole u vezi troškova su sprovedeni i postavljeni u organizativnim i finansijskim pravilima i pravilnicima kao i prati regularno finansijske promene od MF.

Čuva i arhivira originalne kopije svih uplata vršenih za Tužilački sistem.

Od SIMFK evidentira i raportira o stanju sprovođenja budžeta i za svaku eventualnu promenu u SIMFK.

Odgovorani je za sve avanse službenih putovanja po zahtevima.

Vrši ostale dužnosti prosleđene od rukovodioca.

Poznavanja, spretnosti i sposobnosti za radno mesto:

Obuka iz oblasti finansija,

Poznavanje i primena programa Microsoft Office, kao i softvera i finansijskih web aplikacija

Sposobnosti koordinacije, saradnje i komuniciranja sa službenicima i strankama.

Odlučne organizativne i timske sposobnosti za rad pod minimalnim nadzorom.

Da ima sposobnosti za rad pod pritiskom i u vremenskim rokovima.

Fleksibilnost i sposobnost za rad uz visoki volum istog.

Sposobnosti održanja kvaliteta rada i pod uslovima rada pod pritiskom.

Stručna sprema i kvalifikacije:

Univerzitetska diploma, Ekonomski Fakultet.

Radno iskustvo:

Dve (2) godine profesionalnog iskustva.

- Konkurs je otvoren 7 kalendarskih dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Tužilačkog Sistema Kosova, kao i u dneve novine, počevši od 29.12.2022 do 04.01.2023 kao datum isteka konkursa.
- Prijava (aplikacije) za zaposlenje dostupna je na Internetu: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacije se predaju svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, u Diviziji Ljudskih Resursa, VII sprat, Kancelarija br. 702, Priština, Kosovo.
- Prijava poštom: Zahtevi popunjeni dokumentima takođe se mogu predati poštom Odeljenju za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Rr. „Luan Haradinaj“, br. 100 Sprat 7, kancelarija br. 702, 10000 Priština.
- Aplikacije poslate putem pošte**, koje sadrže poštanski pečat nad pošiljkom sa datumom poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se važećim i uzeće se na razmatranje, ako stižu u roku od 4 dana, aplikacije koje stižu posle ovog roka ili su nekompletirane neće se uzeti u obzir uopšte.
- U slučaju potrebe možete da nas kontaktirate na, tel: 038 / 200 18874 od 08:00 do 16:00 časova.
- Uslovi učešća na konkursu:**Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politička prava, imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za vršenje dužnosti kao i fizičkih sposobnosti koja se traže za dotičnu poziciju.
- Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije od svojih osoba muškog i ženskog pola iz redova svih zajednica na Kosovu.
- "Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne državne administracije kao što je specifikovano članom 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova".
- Aplikacijama se moraju sastaviti kopije zatražene dokumentacije:**
 - Svedočanstvo školske spreme;
 - Dokaz o radnom iskustvu; Potorda i radni ugovor;
 - Dokaz o obuci;
 - Dve preporuke (ako imate);
 - Kopije dva poslednja naizmenična izveštaja procene rada (ako takvi postoje);
 - Dokument identifikacije-fotokopirana lična karta;
 - Uverenje od Suda da niste pod istragom.
- U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjua, za kandidate koji ispunjavaju uslove koji su predviđeni na osnovu ovog konkursa, kandidati biće obavešteni na osnovu važećeg zakonodavstva.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020 si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 307/2022 të datës 15 Shkurt 2022, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

KONKURS

I. Zyrtar Ligjor 2

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, një (1) pozitë

Referenca:	KPK/SKPK/POZ - 029
Emri pozitës:	Zyrtar Ligjor 2
Pozita:	Pozitë e karrierës
Niveli:	Profesional
Raporton tek:	Udhëheqësi i Zyrës Ligjore
Numri i pozitave:	Një (1) pozitë
Koeficienti:	Shtatë (7)
Akti i emërimit:	Pa afat
Puna Provuese:	Dymbëdhjetë (12) muaj
Vendi:	Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Ndërmerr të gjitha veprimet konkrete dhe iniciativa profesionale për kryerjen sa më efektive dhe kualitative të punëve në Zyrës Ligjore duke i ofruar mbështetje profesionale juridike në hartimin e akteve normative dhe akteve të tjera juridike.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Harton akte normative dhe aktet tjera juridike nga veprimtaria e Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;
Bën hulumtime dhe analiza të informatave në temat eaktuara nga mbikëqyrësi dhe identifikon opsionet ose çështjet për shqyrtim;
Sipas kërkesës dhe sipas udhëzimeve të mbikëqyrësit jep opinione ligjore si dhe bën hartimin e projektmarëveshjeve, projektvendimeve dhe projekt akteve të tjera;
Bashkëpunon dhe komunikon me njësitë organizative të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit për aktivitetet që ndërlihen me fushën e legjislacionit;
Ndhmon në zbatimin e vendimeve dhe rregullores të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit, përmes dhënies së mendimeve profesionale dhe keshillave juridike;
Kujdeset që përmbajtja dhe forma e akteve normative të jetë sa më e saktë, si dhe të jenë identike në dy gjuhët zyrtare;
Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen nga mbikëqyrësi.

I obliguar të respektojë Kodin e Etikës Profesionale të stafit mbështetës dhe Kodin e Shërbimit Civil.

Njohuritë, shkathësitë aftësitë për vendin e punës:

Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga juridik dhe administratës publike;
Njohuri e gjuhës angleze e preferueshme;
Njohuri me aftësi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word, Excel, Power Point etj) dhe internetin;
Shkathësi për shqyrtimin e lëndëve, hartim të propozim akuzave, aktakuzave dhe shkresave tjera të nevojshme;
Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe keshillave profesionale;
Aftësi për ta mbajtur kualitetin e punës edhe në kushte të punës nën presion.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare - Fakulteti Juridik.

Përvoja e Punës:

Një (1) vit përvojë pune profesionale.

- Konkursi është i hapur 15 ditë kalendrike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data 29.12.2022 deri me datë 12.01.2023 si datë e mbylljes së konkursit.
- Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati VII, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë.
- Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.
- Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.
- Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 - 16:00.
- Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:
- Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.
- Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
- "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuara të dokumentacionit të kërkuar:
- Dëshminë e kualifikimit shkollor;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Dëshmi e trajnimeve;
- Dy rekomandime (nëse keni);
- Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
- Dokumentin e identifikimit - letërnjoftimi i fotokopjuar;
- Certifikatë nga Gjykata që nuk jeni në hetim.
- Në lidhje me datën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, kandidatët do të njoftohen bazuar në legjislacionin në fuqi.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Na osnovu člana 31 Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu Zakona br.03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosova i Pravilnika br. 02/2010 o Postupku Zapošljavanja u Civilnoj Službi Kosova, u skladu sa Presudom br. Ref AGJ.1583/20 od 09. jula 2020. godine kao i Odluke Tužilačkog Saveta Kosova KPK/br. 307/2022 od 15 februar 2022. godine, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova ponovno objavljivanje:

KONKURS

I. Pravni Službenik

Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, jedna (1) pozicija

Referenca:	KPK/SKPK/POZ - 029
Naziv pozicije:	Pravni Službenik 2
Pozicija:	Pozicija karijere
Nivo:	Profesionalni
Izveštava:	Rukovodiocu Pravne Kancelarije
Broj pozicija:	Jedna (1) pozicija
Koeficientat:	Sedam (7)
Akt imenovanja:	Na neodređeno
Probni Rad:	Dvanaest (12) meseci
Mesto:	Priština

Namena radnog mesta:

Preduzima sve konkretne radnje i profesionalne inicijative za efektivnije i kvalitativnije obavljanje poslova u Pravnoj Kancelariji pružajući pravnu stručnu podršku u izradi normativnih akata i ostalih pravnih akata.

Glavne dužnosti i odgovornosti:

Izradi normativne akte i ostale pravne akte iz delatnosti Saveta i Državnog Tužioca na osnovu određenih procedura na osnovu zakonodavstva koji je na snagu;
Pobrine se da sadržaj i oblik normativnih akata bude što tačniji, kao i da bude identičan na dva službena jezika;

Istražuje i analizira informacije u temama koje su određene od strane nadzornog i identifikuje opcije i pitanja za razmatranje;

Na osnovu zahteva i upustva nadzornog daje pravna mišljenja kao i vrši izradu projekt sporazuma, projekt odluka i ostalih projekt akata;

Sarađuje i komunicira sa organizativnim jedinicama Saveta i Državnog Tužioca o aktivnostima vezane za pravosudnu oblast;

Pomaže u sprovođenju odluka i pravilnika Saveta i Državnog Tužioca, putem davanja stručnih mišljenja i pravnih saveta;

Obavlja i ostale zadatke u skladu sa svrhom radnog mesta koje se mogu zahtevati od strane nadzornog;

Obavezan da poštuje Kodeks Profesionalne Etike, pomoćnog osoblja i Kodeks Civilne Službe;

Znanja, veštine i sposobnosti za radno mesto:

Odlučno celokupno profesionalno poznavanje iz Pravne oblasti i Javne Uprave;

Dobro poznavanje albanskog jezika, i/ili engleskog jezika poželjno, usmeno i pismeno, uključujući razvijene sposobnosti u izradi dokumenata;

Poznavanje uz dobre sposobnosti rada kompjuterom uz aplikaciju programa (Microsoft Word, Excel,

Power Point itd.) i internet;

Veštine za razmatranje predmeta, izrada optužnih predloga, optužnica i ostalih potrebnih dokumenata;

Sposobnost za preduzimanje konkretnih inicijativa tokom rada i vezano sa tim;

Sposobnost da zadrži kvalitet rada i pod uslovima rada pod pritiskom..

Profesionalna priprema i kvalifikacija:

Univerzitetska Diploma, Pravni Fakultet.

Radno iskustvo:

Jedan (1) godine profesionalnog radnog iskustva.

- Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Tužilačkog Sistema Kosova, kao i u dnevne novine, počevši od 29.12.2022 do 12.01.2023 kao datum isteka konkursa.
- Prijava (aplikacije) za zaposlenje dostupna je na Internetu: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacije se predaju svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, u Diviziji Ljudskih Resursa, VII sprat, Kancelarija br. 702, Priština, Kosovo.
- Prijava poštom: Zahtevi popunjeni dokumentima takođe se mogu predati poštom Odeljenju za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Rr. „Luan Haradinaj“, br. 100 Sprat 7, kancelarija br. 702, 10000 Priština.
- Aplikacije poslate putem pošte, koje sadrže poštanski pečat nad pošiljkom sa datumom poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se važećim i uzeće se na razmatranje, ako stižu u roku od 4 dana, aplikacije koje stižu posle ovog roka ili su nekompletirane neće se uzeti u obzir uopšte.
- U slučaju potrebe možete da nas kontaktirate na, tel: 038 / 200 18874 od 08:00 do 16:00 časova.
- Uslovi učesća na konkursu: Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politička prava, imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za vršenje dužnosti kao i fizičkih sposobnosti koja se traže za dotičnu poziciju.
- Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije od sviju osoba muškog i ženskog pola iz redova svih zajednica na Kosovu.
- Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne državne administracije kao što je specifikovano članom 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova".
- Aplikacijama se moraju sastaviti kopije zatražene dokumentacije:
 - Svedočanstvo školske spreme;
 - Dokaz o radnom iskustvu; Potvrda i radni ugovor;
 - Dokaz o obuci;
 - Dve preporuke (ako imate);
 - Kopije dva poslednja naizmenična izveštaja procene rada (ako takvi postoje);
 - Dokument identifikacije-fotokopirana lična karta;
 - Uverenje od Suda da niste pod istragom.
- U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjua, za kandidate koji ispunjavaju uslove koji su predviđeni na osnovu ovog konkursa, kandidati biće obavesteni na osnovu važećeg zakonodavstva.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Panda-T" Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për prodhimin dhe montimin e mjeteve piroteknike fishekzjarrëve në Vranidoll, Prishtinë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 26.01.2023 në ora 10:00 në hapësirat e restorant "Villa Natyra", Vranidoll, Prishtinë do të organizohet debat publik nga Kompania "Panda-T" Sh.p.k Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për prodhimin dhe montimin e mjeteve piroteknike fishekzjarrëve në Vranidoll, Prishtinë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=LDGVQdwZbO4JFAhXW2Qt6ytDnYFLf.1>

Meeting ID: 454 934 4495

Passcode: aeda2019

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Panda-T" Sh.p.k Prishtinë për prodhimin dhe montimin e mjeteve piroteknike fishekzjarrëve në Vranidoll, Prishtinë.

<https://mmphi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Panda-T%20Sh.P.K.%202022.pdf>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "AlbItaly Web" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810099508 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "AlbItaly Web" D.O.O. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810099508 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "AlbItaly Web" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810099508 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "KDK- Kosova" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330241547.

- Fitore Kabashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - Ixshfmu " Dëshmorët e Kabashit " Korishe.

- Asan Pandi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Ferit Ahmetaj shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Kujtese Kokalla nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl.I,II,III,IV të Gjumnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Hajrush Bardhi shpall te pavlefshme dëftesën e Kl. VIII shkolla Filllore IlazThaqi, Hani i Elezit.

- Hajri Hamzaj shpall të pavlefshme dëftesat si dhe Diplomën e shkollës së mesme të Mjekësisë "Ali Sokoli" Prishtinë.

- OJQ Klubi i basketbollit " Vushtrria" shpalle te pavlefshme certifikatën e numrit fiskal me nr: 601635157.

- Gramos Rakateli shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani".

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

